



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2019:130039

Datë: 28.04.2021

Numri i dokumentit: 01742744

**C. nr. 229/19.**

**GJYKATA E THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Civil**, sipas gjyqtarit Migjen Kastrati, në çështjen juridiko - kontestimore të paditësit Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS”, adresa Rr. Lidhja e Pejës, pn., 10000, Prishtinë, të cilën e përfaqëson M. K., sipas autorizimit, kundër të paditurit: Z. (Sh.) H., nga fshati ....., rr. ...., Komuna e ....., baza Juridike, për Rimbursimin e dëmit, vlera e kontesti 619.00 euro, në prezencën e të autorizuarës së paditëses, dhe të paditurit, në seancën publike të shqyrtimit kryesor, me dt. 27.04.2021, dhe përpiluar me dt. 28.04.2021 bie:

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR**, kërkesëpadia e paditëses : Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, Rr. Lidhja e Pejës, p.n., dhe **DETYROHET** i padituri Z. (Sh.) H., nga fshati .....ë, Rr. ...., Komuna e ....., që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit material, për aksidentin e dt. 10.10.2017, ti paguaj shumën në lartësi prej, 619.00 euro, me kamat ligjore prej 8%, duke filluar nga dt. 27.04.2021, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 120.00 Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënimit të përmbarimit me detyrim.

**A r s y e t i m**

Paditësja nëpërmes të autorizuarës të saj, me padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke deklaruar se kemi pranuar përgjigje në padi me kohë e duke shtuar si në vijim: në bazë të LSDA dhe shkresave të lendes vërtetohet se i padituri në ditën e aksidentit përveç se nuk kishte mbulesë të sigurimit i njëjti me veprimin e tij në mënyre të kundërligjshme duke u kyçur në mënyrë të pa sigurt kishte shkaktuar dëme materiale të dëmtuarit F. N., për të realizuar kërkesën për dëmshpërblim i dëmtuari kishte paraqitur kërkesë për zhdëmtim dhe tani paditësja konformë kompetencave ligjore të LSDA, kishte kompensuar demin dhe tani në këtë procedurë rimbursimin kërkon nga shkaktari i aksidentit rimbursimin e demit të specifikuar si në petitumin e padisë me gjerësisht. Sa i përket përgjigjes në padi deklaroi se tani në këtë procedurë është jo relevantë referati i kundërshtimit lidhur me padinë për më shumë dhe vet i padituri ka deklaruar se sipas aktvendimit nr. K.nr.1346/2017 dt.25.06.2019 është shpallur fajtor dhe është dënuar lidhur me këtë kundërvajtje, andaj konsiderojmë se janë përmbushur të gjitha elementet për administrimin e provave të bashkangjitura në padi. Njëherë me qellim të ekonomizimit të procedurës shprehim gatishmërinë që këtë çështje ta mbyllim me pajtim gjyqësor duke konsideruar se kjo marrëveshje do të ishte e favorshme për të paditurin. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, me administrimin e provave në shkresat e lendes e cila përfshin ekspertizën komunikacionit dhe aktgjykimin për të cilin është shpallur përgjegjës i padituri këto dy prova vërtetojnë besueshmërinë e kërkesëpadisë andaj kërkojmë edhe nga gjykata që të njëjtën ta aprovoi në tërësi si të bazuar duke e

detyruar të paditurin që në emër të rimbursimi të dëmit të paguaj shumen prej, 619.00 Euro, shumë kjo e cila i është kompensuar palës së dëmtuar në këtë aksidenti sipas LSDA. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar- specifikuar dhe atë, 100 euro për ekspertizën e komunikacionit rrugorë, dhe 20 euro për taksen për padi.

I paditurit me anë të përgjigjes në padi, gjatë seancës gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi të dhënave me shkrim dorëzuar në këtë gjykatë duke deklaruar se e kontestoi në tërësi raportin policor në tërësi është i njëanshëm me apo pa dashje, unë nuk kam qenë prezent kur është përpiluar në atë moment kam qenë duke u marr me dokumentet e kombit, në kishim një ujdë, një marrëveshje gojore me Fadil Nekaj. I njëjti nuk i është përmbajtur marrëveshjes, gjykatës i propozoi që në cilësinë e dëshmitareve të dëgjohet F. N., N. A., dëshmitar i rastit dhe zyrtaret policor të cilët e kanë hartuar raportin V. H. i cili në momentin e aksidentit ka qenë duke dale në punë. Si dhe në cilësinë e dëshmitarit të dëgjohet F. H.. ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se padrejtësisht jam paditur, me një raport policor që e kam kundërshtuar nga fillimi e që është i njëanshëm në sqarimet e ekspertit të komunikacionit unë nuk jam fajtor, e kam huazuar automjetin për të mbijetuar saktësisht për të punuar për familjen ngase kam pagë të ulët dhe kam obligime financiare prej 405 Euro, pagesë mujore, dëshmi e kam raportin bankar, kërkoi nga Kompania e Sigurimeve mirëkuptim dhe meqenëse për sigurime paguajnë Kompanitë e sigurimeve e jo mua, mbetem me shpresë se gjykata këto argumente reale ti marr përbuzë dhe këtë padi ta kthejë mbrapa - përkatësisht ta refuzoi si të pa bazuar. Dhe për fund kërkoi nga paditësja që ta tërheq padinë ti kërkoi të hollat nga tjetërkush e jo nga unë. Vet huazimi i automjeti nuk do të thotë se unë do të ngarkohem edhe me sigurimin e automjetit që unë nuk e kam ditë, edhe ashtu jam dëmtuar mjaft për riparimin e automjetit që e kam riparuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar - specifikuar.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: raporti i policisë - raporti i aksidentit me nr. 2017-DF-534, i dt. 10.10.2017, pasqyrat e transferit bankar të datës 08.12.2017 e lëshuar nga BKS për bankën BPB, ujdia jashtëgjyqësore lëshuar nga BKS me nr. protokollin 1607/17 të datës, 01.12.2017, 7 foto në formatin fotokopje të veturës të përfshirë në aksident, konfirmimi i sigurimeve i lëshuar nga KS DUKAGJINI, si dhe deklaratimet e të autorizuarës të paditëse dhe të paditurit.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike - civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, pasi që:

Në bazë të provave të administruara e posaçërisht nga raporti i policisë, 2017-DF-534, të dt. 10.10.2017, rrëfimi i aksidentit me dt. dhe nr. të njëjte, dhe nga ekspertiza e komunikacionit e punuar nga eksperti i komunikacionit N. N., me datën, 18.01.2021, e dorëzuar në gjykatë me datën, 18.01.2021, si dhe nga konfirmimi i policës së sigurimit të paditurit, gjykata erdhi në përfundimin se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me dt. 10.10.2017, dhe si pasojë e këtij i shkaktohet dëm të dëmtuari F. N..

Nga provat e administruara gjykata ka konstatuar se : Me datën, 10.10.2017, kishte ndodhur aksident trafiku në mesë dy automjeteve me dëme materiale, automjeti A Kamioni tipit ....., ngjyrë e bardhë, pa targa pronë e F. Z. H., të cilën e ngiste Z. Sh. H., i cili kishte patente shofer, kurse sigurim dhe regjistrim nuk kishte për automjetin, automjeti B, automjet për pasagjer ngjyrë e kaltër me traga të regjistrimit ....., pronë e F. B. N., nga fshati ....., i cili

posedonte tërë dokumentacion valid, në lokacionin e drejtimit të rrugës .....- ....., drejtimi i ....., në fshatin ..... të udhëkryqi i rrugës për .....

Për të vërtetuar këtë gjendje gjykata mori për bazë dhe ja fali besimin në tërësi ekspertizës së komunikacionit rrugor të dt.18.01.2021 e dorëzuar në gjykatë me datën, 18.01.2021 të punuar nga eksperti i komunikacionit rrugor N. N., si dhe sqarimet e dhëna në seancë e shqyrtimit kryesor të datës, 27.04.2021, i cili në tërësi ka deklaruar se mbetet pranë ekspertizës me shkrim.

I padituri, Z. H., ditën kritike me datë: 10.10.2017 rrethe orës, 15:15, ka drejtuar veturën TOYOTA LH 80 L, me targa të regjistrimit KL PZ 72, i pa siguruar me polic të vlefshëm.

Nga leximi i Aktgjykimit më numër K.nr.1346/2017, i datës 25.06.2019, i Gjykatës Themelore në Pejë- dega në Istog, divizioni për kundërvajtje, gjykata e ka vërtetuar faktin së i paditurit, Z. H., është përgjegjës, për kundërvajtje nga neni 41.3 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor, dhe në bazë të Ligjit për kundërvajtje i është shqiptuar masa e Qortimit.

Nga dokumenti urdhër transferim i datës, 08.12.2017, gjykata konstaton se të dëmtuarit respektivisht të autorizuarit të tij av. B. B., në xhirollogarinë e të autorizuarit të tij, ju është paguar në tërësi dëmi i shkaktuar sipas këtij aksidenti, në shumën totale prej, 619.00 euro.

Baza juridike e kërkesë padisë, që i padituri të jetë përgjegjëse për rimbursimin e dëmit paditëses gjejnë mbështetje në dispozitat e nenit 9 dhe 14 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësive (ligji nr.04/L-018) e lidhur me dispozitat e nenit 245 par.1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Paditësja është dashur ta kompensoj dëmin të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit rrugor të dt. 10.10.2017, në bazë të dispozitës së nenit 9 dhe 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësive (ligji nr.04/L-018) në të cilin shprehimisht parashihet se : personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja. Në rast dëmi të shkaktuar nga mjete motorik sipas paragrafit 1. të këtij neni, Byroja garanton për detyrime në kuadër të limiteve të përcaktuara sipas nenit 13 të këtij ligji. Byroja mund t'ia delegojë trajtimin dhe pagesën e këtyre dëmeve njërit prej anëtarëve të vet ose një strukture të specializuar për trajtimin e dëmeve të licencuar nga BQK-ja, e cila është e detyruar të trajtojë dhe të paguajë dëmin me shpenzimet e fondit të kompensimit. Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat.

Meqenëse paditësja në bazë të provave prezent në shkresat të lëndës e ka përmbushur detyrimin ndaj të dëmtuarit si pasojë e këtij aksidenti ka të drejtë që të kërkojë rimbursimin e shumës së paguar në bazë të nenit 18 pa 4, të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësive (ligji nr.04/L-018) me të cilën dispozite është parapare se *Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat.*

Gjykata me rastin e vendosje ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurit të dhëna në përgjigjeje në padi, si dhe deklarimet gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe kundërshtimet e dhëna në fjalën përfundimtare, mirë po të njëjtat nuk kishin ndikim që gjykata të vendos ndryshe. Sa i përket propozimit të paditurit që në cilin e dëshmitareve të dëgjohen dëshmitaret e propozuara në shqyrtim gjyqësor, gjykatë një propozim të tillë e ka refuzuar për faktin se në këtë çështje, si mjete provues, respektivisht të provuarit është orientuar gjegjësisht është bërë me anë të

provave materiale dhe atë Ekspertiza e Komunikacionit Rrugorë, pastaj edhe fakti i pa kontestueshëm në mese palëve ishte edhe se i padituri ishte shpallur përgjegjës për këtë aksident me aktgjykimi të gjykatës në procedurën për kundërvajtje, dhe provat e tjera materiale – shkresore, si dhe deklaratimet e ndërgjyqësve të procedura në shqyrtimi kryesor.

E duke iu referuar dispozitës së nenit 7 të ligjit të procedurës kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjithat faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të ligjit të procedurës kontestimore, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë ti provojs faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Meqenëse i autorizuari i të paditurit me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar të kundërtën e dëmit të pretenduar, andaj gjykata e vënë para një situatë të tillë dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi, ndaj paditëses për rimbursimin e dëmit, në shumën prej, 619.00 euro, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 245 paragraf 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet të Detyrimeve, i cili shprehimisht parasheh se kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve, është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbush detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi sikur është përmbajtja e tij, dhe si rezultat i kësaj paditësjë ka paguar në tërësi dëmin që e ka shkaktuar i padituri, me ç ‘rast i padituri ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësen, në të cilin raport paditësjë e ka cilësinë e kreditorit kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, për arsye se i padituri ka mësuar me vonesë për detyrimin-rimbursimin e dëmit të shkaktuar nga data e vendosjes nga gjykata.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 e lidhur me nenin 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të paditurin e detyroi që shpenzimet ti paguaj dhe atë 20 Euro, në emër të taksës për padi, si dhe shumën prej 100 euro në emër të ekspertizës së komunikacionit të punuar nga eksperti N. N., e në shumën e përgjithshme prej, 120 Euro.

Nga arsyet e cekura si më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 të LPK - së.

**NGA GJYKATA E THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.229/19, date, 27.04.2021.**

**G j y q t a r i**  
**Migjen Kastrati**

**Udhëzim juridik:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes të kësaj gjykate.